

MARENGLËN KASMI**ASPEKTE TË LUFTËS SË TIRANËS DHE LARGIMI
I WEHRMACHT-IT NGA SHQIPËRIA NË NËNTOR 1944**

Në historiografinë shqiptare, trajtimi i periudhës së pushtimit gjerman (shtator 1943 – nëntor 1944) gjatë Luftës së Dytë Botërore përbën një nga çështjet historike më të diskutuara në Shqipëri. Pyetje si, nëse ushtria gjermane ishte kalimtare apo pushtuese¹, nëse ishte e nevojshme lufta kundër Wehrmacht-it gjerman², apo që nëse kjo luftë çoi vetëm në humbjen e kotë të jetës së njerëzve për një fitore, e cila do të përcaktohej në fronte të tjera dhe nëse Balli Kombëtar dhe Legaliteti luftuan kundër pushtuesit apo u radhitën përkrah tij, si edhe që komunistët provokuan me qëllim një luftë civile për të realizuar synimet e tyre ideologjike përbëjnë thelbin e këtij debati. Shkaku i këtij debati i ka fillimet e tij në politizimin e tejskajshëm të historiografisë shqiptare deri në vitet 1990.

¹ Në datën 09.09.1943, Komandanti i Divizionit të Këmbësorisë 297 së Wehrmacht-it gjerman shpërndaui në njësitë e tij “*Urdhrin Nr. 1 të Divizionit për pushtimin e territoreve shqiptare*”. (Shih Bundesarchiv / Militärarchiv (më tej: BA/MA), RH 26-297 / 77, Anlage 318 – *Bundesarchiv / Militärarchiv - Arkivi Federal / Arkivi Ushtarak*). Në këtë urdhër, krahas masave paraprake të zakonshme për hartimin e një operacioni ushtarak thuhet në pikën pesë të tij (*Disiplina gjatë marshimit*): “*Der Marsch ist ein Kriegsmarsch!*”¹ (*Marshimi është një marshim luftarak!*). Titulli i urdhrit dhe mënyra e hartimit të tij tregojnë qartë që ky ishte një urdhër ushtarak për pushtimin e një vendi. Urdhri Nr. 1 i Divizionit pasohet nga Urdhri Nr. 2 dhe 3 “*Për depërtimin deri në bregdetin Adriatik dhe mbrojtjen e e tij*”, datë 11.09.1943, Urdhri i div. Nr. 4 “*Për mbrojtjen e bregdetit shqiptar*”, datë 18.09.1943. (Shih BA/MA, RH 26-297/ 77). Edhe nga pikëpamja gjuhësore dhe frazeologjike, duke iu referuar fjalorëve shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip, dokumentet gjermane të kohës si edhe literatura përkatëse shkencore, i referohet gjithmonë fjalës “Besetzung” (*pushtim, okupim*), “Besatzungsmacht” (*fuqi okupuese, pushtuese*), “Besatzungszone” (*zonë e okupuar, pushtuar*) etj.

² Wehrmacht-i ishte forca e rregullt ushtarake gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Si çdo ushtri e rregullt ajo funksiononte mbi bazë mobilizimi të përgjithshëm në rast lufte. Në historiografinë shqiptare shpesh, sidomos në atë të paraviteve 1990, trupat gjermane që vepruan në Shqipëri quhen trupa naziste ose SS (Es-Es). Trupat SS ndryshonin nga Wehrmacht-i, sepse kjo armë funksiononte mbi bazë vullnetarizmi dhe një përzgjedhje racore, fizike dhe politike. Këto trupa përbënin një armë ushtarake ideologjike të Nacionalsocializmit dhe u përfshinë gjatë luftës në krime nga më monstruozet.

Studimi i mëtejshëm i kësaj periudhe historike nuk është vetëm një nevojë për të analizuar në mënyrë sa më objektive zhvillimet politike, ekonomike-shoqërore dhe ushtarake në këtë kohë, por po ashtu, ai përbën edhe një nga detyrat kryesore të historiografisë, e cila në mënyrë të vazhdueshme dhe të bazuar në burime të reja arkivore, duhet të rivlerësojë zhvillimet historike në këtë periudhë dhe jo vetëm. Po ashtu, po kaq i rëndësishëm është edhe ndikimi që ka aktualiteti ndaj historisë, sepse çdo gjeneratë ka një perceptim të ndryshëm nga ajo paraardhëse dhe kërkon të dijë diçka të “re” apo “të ndryshme” mbi të shkuarën.

Nisur nga kjo logjikë, bazuar në dokumente arkivore gjermane, pjesërisht të panjohura deri tani, ky studim do të trajtojë disa aspekte të Luftës së Tiranës dhe largimit të Wehrmacht-it gjerman nga Shqipëria në nëntor të vitit 1944. Studimi i dokumenteve të Arkivit Ushtarak në Freiburg, Gjermani, mundëson trajtimin e plotë të kësaj tematike dhe plotëson dimensionin deri diku të munguar historiografik për pushtimin gjerman të Shqipërisë, bazuar në burime primare arkivore.³ Duke krahasuar këto burime me ato britanike e shqiptare, arrihet në krijimin e një tabloje më të qartë në lidhje me tematikën dhe mund të arrihet në konkluzione më të plota.

Fillimisht trajtohen forcat pushtuese gjermane dhe detyrat e tyre operative. Kjo gjë është e rëndësishme sepse, duke krahasuar dokumentet gjermane me ato shqiptare, shohim se studimi i tyre na çon në përfundime të ndryshme. Në një hap të dytë analizohen shkaqet e tërheqjes së Wehrmacht-it gjerman nga Ballkani, e si rrjedhojë edhe nga Shqipëria. Pjesën kryesore të studimit e përbën Lufta e Tiranës dhe largimi i ushtrisë gjermane nga Shqipëria.

Forcat pushtuese dhe detyrat e tyre operative

Pas pushtimit të Shqipërisë, Komandant i Korparmatës XXI Malore, gjenerali Bader, ngriti në Tiranë shtabin e tij.⁴ Në pikëpamje organizative,

³ Në këtë arkiv gjendet një numër i madh dokumentesh ushtarake për periudhën e pushtimit gjerman të Shqipërisë. Përkrah tyre, një vlerë të madhe studimore paraqesin edhe raportet mujore që instancat drejtuese gjermane në Tiranë hartonin për situatën politike dhe ushtarake në Shqipëri. Fatkeqësisht, gjatë tërheqjes nga Tirana, një nga veturat Volkswagen e Shtabit të Divizionit 297, në të cilën po transportohej një pjesë e madhe e dokumentacionit, u godit nga partizanët dhe dokumentet u dogjën.

⁴ Christoph Stamm, "Zur deutschen Besetzung Albaniens 1943-1944", in *Militär-geschichtliche Mitteilungen*, Bd. 2, Jahr 1981 (Herausgegeben vom Militärgeschichtlichen Forschungsamt), f. 104. Gjenerali i artilerisë Paul Bader u zëvendësua më datë 10 tetor 1943 me gjeneralin tankist Gustav Fehn.

Korparmata XXI Malore ishte pjesë dhe në varësi të Armatës së 2-të tankiste, e cila varej nga Grupimi Luftarak F i Forcave Tokësore me qendër në Beograd, që komandohej nga Gjeneralfeldmarshalli Maximilian von Weichs, i cili ishte njëkohësisht edhe Komandanti i Përgjithshëm i Juglindjes. Një veçori përbënte fakti që, dy qytete shqiptare, Korça dhe Gjirokastra, ishin në varësi operative të Korparmatisë XXII Malore, e vendosur në Greqinë e Veriut, e cila ishte në varësi të Grupimit Luftarak E të Forcave Tokësore.

Sipas Ditarit Luftarak të Komandës së Lartë të Wehrmacht-it, Korparmata XXI Malore përbëhej nga: Divizioni 118 i këmbërorisë së lehtë (Div.), Divizioni 297 i këmbërorisë (në formatim), Divizioni 100 i këmbërorisë së lehtë, Divizioni 181 i këmbërorisë së lehtë (duke u transportuar).⁵

Prej mesit të tetorit 1943, Div. 118 u zëvendësua me Div. 181 të Këmbërorisë. Edhe ky divizion kaloi më vonë, si pasojë e riformatimeve të forcave gjermane, në Mal të Zi nën komandën e Korparmatisë së 5-të Malore. Kësisoj që, në territorin shqiptar mbetën vetëm dy divizione të stacionuara, përkatësisht Div. 297 i Këmbërorisë dhe Div. 100 i Këmbërorisë së Lehtë.⁶

⁵ Percy Ernst (Hrsg.) Schramm, *Kriegstagebuch des Oberkommandos der Wehrmacht 1940-1945*, Bd. 3, Frankfurt am Main 1962, S. 1160. (*Ditari luftarak i Komandës së Lartë të Wehrmacht-it*) (KTB).

Christoph Stamm shkruan se gjenerali Bader dhe më vonë gjenerali Fehn, kishin fillimisht tre divizione nën komandë, përkatësisht Divizionin e 100-të dhe 181-të të këmbërorisë së lehtë, dhe Divizionin 297 të këmbërorisë, si edhe Regjimentin 92 të këmbërorisë së motorizuar dhe njësi të artilerisë bregdetare. Më vonë Divizioni 100 u tërhoq nga Shqipëria. (Ch. Stamm, "Zur deutschen Besetzung Albaniens...", f. 104).

⁶ KTB, Band 4, S. 611.

Historianët shqiptarë japin të dhëna të ndryshme për forcat ushtarake gjermane. Ata shkruajnë se, në dimrin e vitit 1943 dhe verën e vitit 1944, trupat gjermane në Shqipëri arritën në afro 70.000 burra. (Shih *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare*, vëll. 3, botim i Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1988, f. 62). Sipas Ditarit Luftarak të Komandës së Përgjithshme të Wehrmacht-it ky numër forcash nuk ka qenë real as në ditët e para të pushtimit. Në të shkruhet gjithashtu se që prej fillimit të pushtimit janë tërhequr trupa nga Shqipëria dhe nuk janë futur trupa zëvendësuese.

Në një telegram të datës 16 tetor 1943 që konsulli gjerman Schliep i dërgonte Neubacher-it, ai jep një numër prej 57.000 ushtarësh gjermanë që vepronin në Shqipëri. (PA/AA, Büro des Staatssekretärs, Albanien (1), Schliep, 16.10.43, f. 251088). Në të njëjtën kohë jepet, nga të dhënat e negociatave ekonomike gjermano-shqiptare, një numër prej afërsisht 30.000 ushtarësh. (Bernhard Kühmel, *Deutschland und Albanien, 1943-1944. Die Auswirkungen der Besetzung und die innenpolitische Entwicklungen des Landes*, Bochum: 1981 (Inauguraldissertation zur Erlangung eines

Më 22 shkurt 1944, Div. 100 i këmbësonisë u zëvendësua nga Div. 181 i Këmbësonisë. Përkrah këtyre divizioneve, në Shqipëri operonin, prej 1 Shkurtit 1944, edhe Regjimenti i Kundërspiunazhit (*Abwehr II*) “Brandenburg”, dy batalione turkmenësh dhe një repart artilerie.⁷

Në rast se do të llogaritet edhe Divizioni I Malor, që operonte në rajonin Janinë-Tepelenë dhe që përbënte njëkohësisht edhe forcat rezervë të Grupimit Luftarak E⁸, formohej një numër prej afërsisht pesë divizionesh, të cilët duhej të mbanin të pushtuar Shqipërinë dhe Malin e Zi. E njëjta hapësirë ishte mbajtur më parë me shumë sforcë nën kontroll nga tetë divizione italiane.

Detyra kryesore e këtyre divizioneve ishte padyshim organizimi i mbrojtjes së vijës bregdetare nga ndonjë zbarkim i mundshëm i forcave aleate. Kjo detyrë nënkuptonte pushtimin e territoreve të rëndësishëm bregdetarë, ndërtimin dhe zgjerimin e pozicioneve të artilerisë bregdetare dhe rikthimin në gjendje luftarake të baterive të artilerisë bregdetare, që u ishin kapur forcave italiane.⁹

Tërheqja e Wehrmacht-it gjerman nga Ballkani

Dalja e Rumanisë nga aleanca e saj me Gjermaninë në muajin gusht 1944 e përkeqësoi gjendjen e trupave gjermane që mbanin të pushtuar Evropën Juglindore. Ushtria e Kuqe e shfrytëzoi të çarën e krijuar në vijat

Doktors der Philosophie in der Abteilung für Geschichtswissenschaft der Ruhr-Universität Bochum, f. 207).

Nëse vlerësojmë strukturën organizative të ushtrisë gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore, arrijmë në përfundimin se, sipas rregulloreve organizative, divizionet e Wehrmacht-it gjerman përbëheshin nga 2-3 regjimente dhe njësi të tjera mbështetëse. Struktura e autorizuar e një divizioni këmbësorie duhej të ishte e përbërë nga 352 oficerë, 1947 nënoficerë, 9581 ushtarë dhe 29 punonjës civilë, pra gjithsej rreth 11.909 burra. Duhet theksuar se, në dy vitet e fundit të luftës, në divizionet gjermane që ishin të dislokuara në Shqipëri, por edhe gjetkë, struktura faktike e personelit të divizionit nuk iu afrua asnjëherë strukturës së autorizuar, por ishte gjithnjë më e vogël. Kësisoj, nëse llogarisim që, në rastin më të mirë, dy divizionet gjermane në Shqipëri kishin së bashku rreth 23.818 burra, së bashku me njësitë e tjera mbështetëse që janë përmendur më sipër, forcat e Armës-SS, trupat e sigurisë, forcat e policisë sekrete (SD), forcat e xhandarmërisë fushore etj., prezenca ushtarake gjermane në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk mund të kenë qenë më shumë se 36.500 burra.

⁷ BA/MA, XXI.AK., 55145/3.

⁸ KTB, Bd. 3, f. 1214.

⁹ B. Kühmel, *Deutschland und Albanien ...*, f. 208; Shih edhe “*Urdhrin Nr. 1 të Divizionit për pushtimin e territoreve shqiptare*” (BA/MA, RH 26-297 / 77).

gjermane të mbrojtjes dhe e shfrytëzoi këtë hapësirë të lirë lëvizjeje drejt perëndimit të Evropës. Duke pasur parasysh se edhe pozitat e Bullgarisë tashmë ishin lëkundur, pozicionet gjermane në Ballkan ishin potencialisht të rrezikuara për t'u shkëputur nga pjesa tjetër e Evropës që dominohej akoma nga Wehrmacht-i gjerman.¹⁰ Në këto kushte, Komanda e Lartë e Wehrmacht-it (*Oberkommando der Wehrmacht, OKW*), lëshoi në datën 2 shtator 1944 urdhrin e përgatitjes për tërheqje të Korparmatës E nga Greqia.¹¹

Urdhri për tërheqjen e trupave gjermane nga Shqipëria u lëshua më 3 tetor 1944, në të njëjtën kohë kur u urdhërua edhe tërheqja e Wehrmacht-it nga Greqia dhe Maqedonia.

Siç është përmendur edhe më sipër, në Greqi operonte Grupimi Luftarak E i Forcave Tokësore me rreth 280.000 forca. Sipas urdhrin, në ditët e para të nëntorit 1944, këto forca kaluan kufirin greko-jugosllav, ndërsa një forcë prej 4000 ushtarësh, nën drejtimin e një komandanti Grup-Artillerie, kolonelit Steyrer, morën detyrë që të vazhdonin tërheqjen në drejtimin Ohër-Elbasan-Tiranë. Detyra luftarake e Grupit Steyrer¹² ishte të kalonte nga vartësia e Korparmatës Malore XXII, që kishte vepruar në Greqi, në atë XXI, e cila mbulonte zonën operative ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Çdo divizion i kësaj Korparmate ishte i dobësuar sepse kishte dhënë forca dhe njësi për frontet e tjerë të luftës, e për rrjedhojë ajo nuk mund të përballonte e vetme luftimet gjatë tërheqjes nga Shqipëria, e sidomos nga Tirana.

Tërheqja e trupave gjermanë të dislokuara në Shqipëri ishte e lidhur ngushtë me tërheqjen e trupave gjermanë nga Greqia. Për këtë arsye, tërheqja e planifikuar operative e Korparmatës Malore XXI kishte një rëndësi të veçantë për fatin e trupave gjermanë që ndodheshin në Ballkanin Perëndimor. Kjo Korparmatë nuk mund të kryente një tërheqje të menjëhershme sepse ekzistonte rreziku i zbarkimit të trupave aleate në bregdetin shqiptar. Si rrjedhojë, kjo Korparmatë duhej të siguronte rrugëkalimin e trupave gjermane në tërheqje. Në kuadër të planifikimeve

¹⁰ KTB, Bd.4, f. 713; Gerhard Hümmelchen, "Balkanräumung", in: *Wehrwissenschaftliche Rundschau*, Frankfurt am Main: 1959, f. 576-577.

¹¹ "Die Große Absetzungsbeziehung im Südosten. Der Rückmarsch der Heeresgruppe E" (KTB, Bd.4, f. 713ff.).

¹² Në rutinën ushtarake gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte e zakonshme që njësitë luftarake të quheshin me emrin e komandantit që i drejtonte.

dhe mendimeve operative, Korparmata XXI Malore kaloi nën komandën e Grupit Luftarak E të Forcave Tokësore.¹³

Pas dhënies së urdhrat të tërheqjes më 3 tetor, Shqipëria u shpall zonë luftarake. Zyrtarisht Shqipëria do të mbetet një shtet i pavarur, gjë që më shumë se kurrë ndonjëherë përbente një fiksim për shqiptarët.¹⁴ Për të ruajtur këtë imazh, nën kujdesin e gjermanëve, më 6 shtator 1944 ishte formuar dhe qeveria e Ibrahim Biçakut. Nëpërmjet këtij veprimi Biçaku “e tregoi edhe njëherë patriotizmin e tij të lartë dhe miqësinë e tij ndaj Gjermanisë” do të shkruante më vonë ish-konsulli i përgjithshëm gjerman Schliep.¹⁵

Më 15 tetor u largua nga Tirana Legata Gjermane. Von Scheiger-i dhe Schliep-i fluturuan drejt Berlinit, ndërsa gjenerali SS Fitzthum-i, i cili më 8 tetor u emërua Shef i Administratës Ushtarake të Shqipërisë dhe Malit të Zi, e transferoi vendkomandën e tij nga Tirana në Prizren. Së bashku me diplomatët dhe punonjësit e Konsullatës së Përgjithshme gjermane u largua edhe një numër i konsiderueshëm shqiptarësh që kishin bashkëpunuar me ta. Ndër të parët që filloi të merrte masa për

¹³ Situata e Grupimit Luftarak E të Forcave Tokësore paraqitet si më poshtë: Komanda e Korparmats Malore XXI, e drejtuar nga Gjenerali i Këmbëorisë von Leyser ndodhej në Tiranë. Divizioni i Këmbëorisë së Mekanizuar 297, drejtuar nga Gjeneralletjënanti Baier ndodhej me shtabin e tij po në Tiranë. Divizioni i Këmbëorisë së Mekanizuar 181 e kishte shtabin e tij në Podgoricë dhe kishte përqendruar forcat e tij më të shumta në rajonin e Kotorit dhe Podgoricës. Të dy divizionet kishin dërguar nga një Grupregjiment prej 2 batalionesh dhe një repart artilerie në Gruparmatën Felber në Beograd. Si pasojë e pakësimit të forcave ishte urdhëruar një bashkim i këtyre trupave të mbetura. Në rajonin Prishtinë-Prizren-Pejë ndodhej Divizioni “Skënderbeg”. Personeli i tij shqiptar nuk ishte i qëndrueshëm, si pasojë e dezertimeve të shumta. Në bregdet, kryesisht në Vlorë, Durrës dhe Kotorr ndodhej Artileria Bregdetare, batalioni 999 dhe forca të këmbëorisë së marinës. Në brendësi të vendit ndodheshin edhe gjashtë batalione italiane dhe po ashtu një repart artilerie italiane që ishin shprehur për të luftuar përkrah gjermanëve. Aerodromet e Tiranës dhe Podgoricës ruheshin nga Luftwaffe-ja gjermane. Anije luftarake dhe avionë nuk kishte në dispozicion. (Erich Schmidt-Richberg, *Das Ende auf dem Balkan. Die OperationenderHeeresgruppe E von Griechenland bis zu denAlpen*, Heidelberg: 1955, S. 70).

¹⁴ Martin Seckendorf, *Die Okkupationspolitik des deutschen Faschismus in Jugoslawien, Griechenland, Albanien, Italien und Ungarn 1941-1945*, Bd. 6 (Europa unterm Hakenkreuz. Die Okkupationspolitik des deutschen Faschismus 1938-1945), Gräfenhainichen 1992, Dokument Nr. 330, f. 372.

¹⁵ *Politisches Archiv des Auswärtigenamts* (më tej: PA/AA), Nachlass von Dr. Martin Schliep. (Erinnerungen des GS a.D Martin B. Schliep an seine Amtszeit in Tirana (1941-1944), 1963, f. 46-47.

largimin nga Shqipëria ishte edhe regjenti Mehdi Frashëri. Këtë e konfirmon edhe konsulli i përgjithshëm Schliep, i cili në datën 10 shtator 1944, njoftonte Neubacher-in në Beograd si më poshtë: *“Mehdi Frashëri më kërkoi sot të organizoja menjëherë dërgimin e një avioni, i cili, në rrugën më të shpejtë duhet të transportojë për në Gjermani atë dhe familjen e tij. I premtova Mehdi Frashërit që kërkesën e tij do ta transmetoja më lart dhe po ashtu u mundova ta qetësoj atë. Pres përgjigjen tuaj”*.¹⁶

Tërheqja e Wehrmacht-it nga Shqipëria - konkretisht e Divizionit 297 të këmbësorisë - filloi në Vlorë në fund të muajit tetor 1944. Lëvizja e trupave gjermane filloi me largimin e trupave të Regjimentit të Motorizuar 523 nga ishulli i Sazanit, tërheqjen e artilerisë bregdetare, xhenierëve dhe forcave të këmbësorisë së marinës. Gjatë natës së 12-13 tetorit 1943 u tërhoqën dhe u përqendruan në Vlorë edhe trupat që mbanin nën mbikëqyrje Qafën e Llogorasë. Më 14 tetor, Regjimenti 523 lëshoi pozicionet e tij në rajonin e Vlorës dhe u përqendrua me të gjitha forcat e tij në rrugën Vlorë-Fier. Në të njëjtën kohë me tërheqjen, Batalioni Xhenier 297 (drejtuar nga Nëntogeri Konheuser) filloi zbatimin e planit të shkatërrimit dhe hedhjes në erë të objekteve ushtarake. Sipas urdhrorit, tërheqja do të organizohej duke përdorur konceptin e „tokës së djegur“, gjë që në realitet nuk u arrit të kryhej. Kodrat e Mallakastrës mbaheshin nga partizanët dhe hapja e rrugës së tërheqjes u arrit me shumë vështirësi vetëm me ndihmën e artilerisë. Në mbrëmjen e 16 tetorit këto forca arritën në Rrogozhinë dhe ndërkohë që forcat e tjera që kishin qenë të stacionuara në Vlorë vazhduan marshimin në drejtim të Durrësit, Regjimenti 523 mori urdher të lëvizte në drejtim të Elbasanit.¹⁷

Si pasojë e ndryshimit të situatës, Korparmata e XXI nuk e kishte më të mundur të mbante një vijë fronti bregdetar prej 220 km (Südostwall –

¹⁶ PA/AA R27304, Telegramme Tirana-Belgrad, telegram i konsullit të Përgjithshëm Schliep dërguar Neubacher-it në Beograd, datë 10.09.1944.

Më 5 shtator 1944, Neubacher kishte udhëzuar Schliep-in në Tiranë, që të merreshin masat dhe të garantohej gjithë ndihma e mundshme për të bërë evakuimin e bashkëpunëtorëve shqiptarë dhe familjeve të tyre, nëse kjo gjë do të kërkohej prej miqve shqiptarë. Gjithsesi, ai porositi se, nuk duhej në asnjë mënyrë të krijoheshin te shqiptarët ideja që, ushtria gjermane po përgatitej të largohej shpejt e shpejt nga Shqipëria (PA/AA R27305, Telegramme Athen-Tirana, Diplogerma Tirana, datë 05.09.1944).

¹⁷ Friedrich Neumann, "Kritische Stationen des Rückzugs aus Albanien", in Alois Beck, *Bis Stalingrad... Albanien und Jugoslawien (1943-1944)*, f. 260.

muri i juglindjes, i cili fillonte prej bregdetit Adriatik e deri në vijën Fushë Kosovë – Shkup-Liqeni i Ohrit). Që prej shtatorit 1944, Divizioni 297, teknikisht ishte i shkëputur nga Gjermania.¹⁸ Tërheqja e tij duhej të realizohej në drejtim të Veriut të Shqipërisë, duke pasur si orientim të përgjithshëm të saj luginat e lumenjve që shtriheshin nga lindja në drejtim të perëndimit të Shqipërisë. Ky plan fillimisht eci mirë.¹⁹

Meqenëse Grupi luftarak Steyrer që po afrohej nga drejtimi i Strugës u godit me ashpërsi në luginën e Shkumbinit nga forcat partizane²⁰ dhe u vonua, një pjesë e Divizionit 297 duhej të ndalonte tërheqjen për disa ditë më shumë se ishte planifikuar nga komandanti i këtij divizioni dhe të kalonte në mbrojtje të detyruar në qytetin e Elbasanit.

Pasi të siguronte rrugëkalimin e tërheqjes së gjithë forcave gjermane në Ballkan, sipas urdhrit të parë të Komandantit të Përgjithshëm të Juglindjes, divizioni duhej të marshonte në drejtimin Nikšić –Trebinje - Mostar (Bosnje-Hercegovinë) dhe aty të bashkohej me trupat e Grupimit Luftarak Tokësor E. Për trupat gjermane që ndodheshin në Shqipëri, kjo do të thoshte se ato duhej të lëviznin nëpërmjet Shqipërisë së Mesme në drejtim të Shqipërisë së Veriut.

Lufta e Tiranës

Marshimi i mëtejshëm i forcave gjermane nga Shqipëria në drejtim të Jugosllavisë u bë gjithmonë e më i vështirë. Sidomos tërheqja e detyruar nëpërmjet kryeqytetit të vendit, Tiranës, u pasua nga një luftë e ashpër brenda qytetit. Në lidhje me këto luftime një ushtar gjerman shkruante në kujtimet e tij: *“Të krijohet përshtypja që Tirana përbëhej vetëm nga partizanë. Në sheshin Skënderbej kishim përgatitur llogore*

¹⁸ Disa muaj më parë, Hitleri e kishte paralajmëruar Komandantin e Grupit të Forcave Tokësore E (Greqia), Gjeneralkolonelin Löhr për rrezikun e krijimit të kësaj situatë. Pra, më 25.08.1944, pas pesë ditësh sulmi, sovjetikët arritën të detyronin Rumaninë të kapitullonte, e cila po ashtu disa ditë më vonë i shpalli luftën Gjermanisë. Të njëjtin shembull ndoqi edhe Bullgaria, e cila i shpalli luftën Gjermanisë në datën 08.09.1944. Në këtë mënyrë Gjermanisë i ishte rrezikuar vija kryesore e furnizimit. Churchill-i i këshilloi bullgarët: *“Ju duhet të marshoni dhe të asgjësoni gjermanët. Me sa më shumë energji të godisni gjermanët, po aq më tepër do shmangni vëmendjen e aleatëve nga ato ç’ka keni bërë më parë!”*. (A. Beck, *Bis Stalingrad... Albanien*, f. 256).

¹⁹ Kurt Mehner, *Die Geheimen Tagesberichte der Deutschen Wehrmachtführung im Zweiten Weltkrieg 1939-1945*, Bd.11, Osnabrück 1984, S. 128.

²⁰ *Po aty*, f. 140.

*dhe në to kishim vendosur mitralozë. Prej këtu mbanim nën zjarr lagjen e ciganëve [te Shallvaret – M.K], Rrugën e Durrësit dhe bulevardin kryesor. Nga malet zbrisnin partizanë që hidhnin granata për t'u ardhur në ndihmë shokëve të tyre që kishin mbushur qytetin. Ditë e natë qëndruam shtrirë në baltë, një dorë te arma dhe me dorën tjetër hanim ose pinim ndonjë cigare. Sa më shumë partizanë vrisnim, aq më shumë shtohet numri i tyre.*²¹

Por si paraqitej situata e forcave gjermane që morën pjesë në luftimet e Tiranës?

Si pasojë e lëvizjeve dhe largimeve sistematike të planëzuara të trupave gjermane nga Shqipëria, në dy javët e para të nëntorit 1944, në Tiranë, nuk ndodhej një trupë e fuqishme ushtarake e mirëfilltë.²² Në qytet ndodheshin komanda e Divizionit 297, spitali ushtarak, depot e municionit, depot ushqimor dhe ato të karburantit si edhe autoreparte, të cilat ishin të plotësuara me efektiv dhe ruheshin nga reparte e nënreparte alarmi. Kjo ishte edhe arsyeja se përse Grupi Steyrer u urdhërua t'u vinte atyre në ndihmë dhe së bashku të vazhdonin tërheqjen në drejtim të Shkodrës.

Në botimin *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare* shkruhet se, në datën 2 nëntor, rreth 2000 trupa që kishin ardhur nga Greqia u nisën nga Elbasani në drejtim të Tiranës.²³ Për këtë periudhë dokumentet dhe literatura gjermane nuk japin ndonjë informacion për një afrim të tillë trupash që vinin nga Greqia me destinacion Tiranën. Ish-komandanti i Regjimentit të Këmbësisë së Mekanizuar 523, Kolonel Friedrich Neumann, regjimenti i të cilit luftoi në Vlorë e më pas gjatë tërheqjes në Elbasan, shkruan se, për t'i ardhur në ndihmë forcave të pakta që ndodheshin në Tiranë, Shtabi i Divizionit 297 urdhëroi që, prej trupave që ndodheshin në Elbasan, të krijohet një batalion, i cili duhej të nisej për në Tiranë. Gjatë marshimit në Kërrabë, ky batalion u godit në luginën e Erzenit dhe iu shkaktuan disa humbje. Pjesa e mbetur e batalionit arriti të hynte në Tiranë.²⁴

²¹ Martin Maller, *Die Fahrt gegen das Ende. Erlebnisse aus den Partisanenkämpfen im Balkan*, Bd.2, Bonn 1962, f. 244.

²² BA/MA, RH 19/VII 39, S. 65.

²³ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare...*, f. 786-787.

²⁴ F. Neumann, "Kritische Stationen des Rückzugs aus Albanien", in: A. Beck, *Bis Stalingrad... Albanien und Jugoslawien (1943-1944)*, S. 261.

Grupi Steyrer hyri në Elbasan në datën 9 dhe 10 nëntor.²⁵ Komandanti i Div. 297, i cili ndodhej në Tiranë, urdhëroi me radio Kolonelin Steyrer të drejtonte personalisht nga pararoja lëvizjen e trupave të tij nga Elbasani për në Tiranë. Pjesa tjetër e mbetur nga Divizioni 297 do të nisej në dy rendime marshimi nga Elbasani në drejtimin Peqin – Rrogozhinë-Vorë. Sipas *Historisë së LANÇ-it*, në Elbasan u përqendruan rreth 6000-6500 trupa gjermane, të përbëra nga forcat e Divizionit 297 dhe grupi luftarak Steyrer.

Historianët ushtarakë të paraviteve 1990 shkruajnë se detyra e këtij Grupi Luftarak (Steyrer) ishte të godiste nga krahët forcat partizane që kishin rrethuar Tiranën e më pas ta ripushtonte atë.²⁶ Madje Mehmet Shehu në librin e tij për çlirimin e Tiranës jep një pamje më të zgjeruar të qëllimeve luftarake të forcave gjermane në këtë kohë. Ndër të tjera ai thotë: *“Kollona që marrshon për Tiranë ka për qëllim që të përparojë gjer në Urën e Erzenit dhe aty të hapet në mënevër grykës së Erzenit, në drejtim të Picallit, për ti rënë pas shpine Brigadës IV dhe Brigadës VIII, si edhe djathtas në drejtim Mullet-Farkë, për ti rënë pas shpine Brigadës I. Kollona tjetër do të kalojë prej Durrësi dhe, pasi të mbledhë me radhë garnizonin e Peqinit të Rrogozhinës, Kavajës, të Durrësit e të Shijakut, të grumbullohet në Vorë, prej ku të lëshojë një sulm në drejtim të Tiranës, për tu rënë pas shpine forcavet tona, për të plotësuar kështu një darë të fortë rreth Tiranës, bashkë me kollonën tjetër, me qëllim që t’asgjesohen forcat tona në Tiranë, të djegin, të plaçkisin, të vrasin sa të duan në Kryeqytet dhe pastaj bashkë me garnizonin e Tiranës të tërhiqen për në Shkodër”*.²⁷

Plani i trupave gjermane ishte tërheqja, prandaj dhe nuk mund të kishin një synim të tillë. Nisur nga kjo logjikë, me të drejtë lind pyetja: Përse duhej që gjermanët të këmbëngulnin e të kërkonin luftime të parëndësishme, ku mund të pësonin humbje, ndërkohë që kishin edhe shumë rrugë për të bërë deri në Gjermani dhe dihej që në Jugosllavi do të hasnin në një luftë edhe më të fortë si pasojë e territorit të madh, por edhe e fuqisë së madhe të ushtrisë partizane jugosllave? Pra, jo vetëm që logjika ushtarake operativo-strategjike, por edhe ajo e thjeshtë nuk mund ta pranojë këtë gjë. Po ashtu edhe urdhrat që kishte marrë Koloneli

²⁵ BA/MA, RH 19/VII 39, S. 62.

²⁶ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ...*, f. 801; Mehmet Shehu, *Lufta për çlirimin e Tiranës*, Tiranë: 1962, f. 55-56.

²⁷ M. Shehu, *Lufta për çlirimin e Tiranës ...*, f. 55-56.

Steyrer nuk e mbështesin një argument të tillë. Ai ishte urdhëruar të ndihmonte me forcat e tij në repartet dhe nënrepartet gjermane të vendosura në Tiranë.²⁸

Duke pasur parasysh përvojën e mbledhur në luftimet kundër partizanëve gjatë lëvizjes nga Struga në drejtimin Qafë Thanë - Librazhd - Elbasan, Steyrer urdhëroi trupat e tij që lëvizja të kryhej pa ruajtur distancat e përcaktuara në rregulloret e marshimit ndërmjet pararojës, pjesës kryesore të kolonës dhe praparojës.²⁹ Respektimi i këtyre distancave mbarte me vete rrezikun, që partizanët të shfrytëzonin këto largësi dhe të godisnin trupat gjermane në lëvizje, t'i ndanin ato nga njëra-tjetra dhe t'u shkaktonin humbje.

Në datën 11 nëntor, ora 15.00, Steyrer, në krye të forcave të tij u nis nga Elbasani në drejtim të Qafë-Kërrabës. Kolona arriti të largohej nga Elbasani pa humbje të mëdha, pavarësisht se në kohën që trupat gjermane kaluan urën (bëhet fjalë për urën e Bradasheshit apo të Kushës – M.K.) ata ranë në një zjarr të dendur të armëve partizane.

Më në fund, kolona gjermane arriti të futej në Tiranë më datën 16 Nëntor. Ajo kishte pësuar humbje të mëdha nga pritjet partizane dhe sulmet e aviacionit anglez dhe amerikan, madje duke u vënë disa herë në situatë të vështirë. Pa hyrë në detaje ushtarake të lëvizjes së këtyre forcave, do të ndalemi vetëm në disa momente të rëndësishme të ngjarjeve.

Steyrer raportonte për datën 15 nëntor sulme të aviacionit aleat ndaj kolonave gjermane që marshonin në Qafë-Kërrabë drejt Tiranës,³⁰ ndërkohë që në *Historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare* shkruhet se “Misioni ushtarak britanik pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH kishte pranuar kërkesën e këtij shtabi për të dërguar aeroplanë luftarakë, që të bombardonin e mitralonin kolonën gjermane në rrugën Elbasan-Tiranë. Mirëpo këta aeroplanë erdhën më 16 nëntor, një ditë pasi kishte marrë fund çdo gjë. Veç kësaj, ata bombarduan dhe mitraluan partizanët që grumbullonin materialet trofe dhe spastronin rrugën nga materialet dhe karrot e shkatërruara, nga kafshët e njerëzit e vrarë”.³¹

Që në Qafë-Kërrabë është kryer një luftë e ashpër ndërmjet partizanëve dhe trupave gjermane nuk ka shteg për diskutim, madje këtë

²⁸ BA/MA, RH 19/VII 39, S. 62.

²⁹ *Po aty*, S. 62.

³⁰ *Po aty*, S. 64.

³¹ *Historia e Luftës Antifashiste nacionalçlirimtare ...*, f. 803.

gjë e konfirmon edhe vetë Koloneli Steyrer i cili, me radio, kërkoi ndihmë në komandën e Divizionit 297 në Tiranë që t'i dërgoheshin tanke e autoblanda për të dalë nga rreziku në të cilin ndodheshin trupat e tij.³² Duke qenë se ai ndodhej në pararojën e kolonës, në krye të katër tankeve italianë dhe dy mjeteve vetëlëvizëse top-kundërajror kalibër 20mm që erdhën nga Tirana, Steyrer u kthye mbrapsht dhe inspektoi gjendjen në forcat kryesore dhe pararojën e kolonës marshuese duke konstatuar se, trupat e tij ndodheshin në një situatë tepër të vështirë dhe kishin humbur shumë njerëz, kafshë transporti e mjete.

Hyrja e trupave Steyrer natën e 15 nëntorit, duke u gdhirë 16 nëntori, në Tiranë u krye nën zjarrin e armëve të rënda të partizanëve të cilat – siç pohon edhe vetë Steyrer - ishin vendosur me mjeshteri në kodrat anash rrugës. Këto goditje shkaktuan humbje të tjera dhe po ashtu e prishën rendin e marshimit të kolonës. Si rrjedhim, trupat gjermane hynë në Tiranë, sidomos njësitë e grupit të qendrës, në mënyrë jo të organizuar.

Steyrer nxitoi me tankun e tij dhe hyri në Tiranë para kolonës dhe mori detyrën: *“Grupi Luftarak do të marshojë nëpër Tiranë dhe do të vendoset te fusha e aviacionit në hyrjen veriperëndimore të Tiranës. [...]Gjatë lëvizjes nëpër qytet do të jepen të plagosurit në spitalin vendor (Ortslazarett) të Tiranës. Vendkomanda e shtabit do të jetë në Hotel Kontinental, ku ndodhet edhe komandanti i mbrojtjes së Tiranës, majori Eckstein. Më 16.11., ora 09.00, koloneli Steyrer të paraqitet në Shtabin e Divizionit.”*³³

Si pasojë e zjarrit partizan brenda qytetit, jo e gjithë kolona arriti të çante rrugën deri te fusha e aviacionit në Laprakë. Një pjesë e saj kaloi në mbrojtje të detyruar brenda qytetit.

Në zonat e qytetit ku luftohej u riorganizua përsëri mbrojtja sipas parimit të mbrojtjes së një baze ushtarake, pra mbrojtje rrethore. Situatën e vështirë që ishte krijuar për forcat gjermane në Tiranë e raporton edhe vetë Steyrer: *“Nga të gjitha rrugët dhe sheshet e qytetit partizanët hapnin një zjarr të rëndë e të vazhdueshëm; nga të gjitha dritaret, ballkonet dhe çatitë shtihej me pushkë, automatikë dhe mitralozë. Bllloqet e veçuara të shtëpive ku ndodheshin trupat gjermane ishin nën zjarrin e artilerisë dhe mortajave. Deri në drekë, zjarri armik u shtua nga ora në orë.”*³⁴

³² BA/MA, RH 19/VII 39, S. 64.

³³ *Po aty*, S. 65.

³⁴ *Po aty*, S. 66.

Në mbledhjen e shtabit të Divizionit 297 të orës 09.00, datë 16 nëntor, mendimi kryesor i rrahur në këtë takim ishte largimi brenda ditës i trupave dhe mjeteve nga qyteti, i cili tashmë thuajse zotërohej nga partizanët.³⁵ Pra, siç u tha edhe më sipër, pavarësisht ardhjes së përforcimeve, nuk kishte asnjë urdhër, tendencë, mundësi apo interes nga trupat gjermane që të vazhdonin të qëndronin në qytet, e jo më të mundoheshin të rimerrnin qytetin e Tiranës, siç shkruan M. Shehu.³⁶ Qëllimi i forcave gjermane ishte të largoheshin nga Tirana duke u tërhequr me luftim e me sa më pak humbje të ishte e mundur të bashkoheshin me trupat e tjera gjermane në Vorë, për të vazhduar më pas së bashku lëvizjen në drejtim të Shkodrës.

Me organizimin e tërheqjes së trupave gjermane nga Tirana, ndoshta bazuar në përvojën luftarake që ai krijoi gjatë marshimit nga Struga në Tiranë, u ngarkua përsëri Koloneli Steyrer.

Steyrer vlerësoi situatën dhe arriti në konkluzionin se, largimi i gjermanëve nga Tirana mund të arrihej vetëm nëpërmjet rrugës në jug të sheshit Skënderbej (*Bulevardi Musolini, tani Rruga e Kavajës – M.K.*). Fillimisht duhej pastruar me luftim rruga brenda qytetit. Më pas, (diku pranë kryqëzimit të 21 Dhjetorit) forcat gjermane do të ktheheshin djathtas drejt fushës së aviacionit, për t'u bashkuar me forcat e tjera që ndodheshin aty e për të lëvizur në drejtim të Vorës ku ishte caktuar edhe pikëtakimi me trupat e tjerë që ishin afruar nga Elbasani nga drejtimi tjetër i tërheqjes.

Rrugëkalimi do të hapej nga dy drejtime, çka përbënte një taktikë të njohur gjermane gjatë luftimit në tërheqje. Konkretisht, Batalioni i Këmbësisë (A.A.) i Divizionit 297, i cili komandohej nga majori Stroschke do të hapte me luftim rrugën e tërheqjes nga fusha e aviacionit në drejtim të qendrës së Tiranës dhe nga sheshi Skënderbej në drejtimin tjetër do të vepronte Batalioni 1007 dhe Batalioni VIII/999, që bënë pjesë në praparojën dhe grupin e qendrës së forcave të Steyrer-it.³⁷

Si pasojë e zjarrit partizan, i cili sipas dokumenteve gjermane ishte gjithnjë në rritje, sidomos në orët e para të pasdites së datës 16 nëntor, dhe pasi Steyrer-i kreu një përnjohje të hollësishme në terrenin ku do të organizohej tërheqja, ai arriti në përfundimin se largimi gjatë ditës ishte i

³⁵ *Po aty*, S. 66.

³⁶ M. Shehu, *Lufta për çlirimin e Tiranës...*, f. 55-56.

³⁷ BA/MA, RH 19/VII 39, S. 65.

pamundur. Po ashtu ai konstatoi edhe mungesën e municioneve, sidomos për topat malorë 75 mm dhe për top-obusët 105 mm, të cilët ishin tepër të vlefshëm për mbulimin e tërheqjes. Mundësia më e madhe e largimit nga qyteti nëpërmjet rrugës jugore (Rrugës së Kavajës –M.K) paraqitej në mbrëmje, duke i vënë flakën shtëpive në të dy krahët e rrugës dhe duke lëvizur mes tyre.³⁸ Në orën 15.00, Steyrer i parashtrroi Komandantit të Div. 297 planin e tërheqjes dhe ky i fundit e miratoi këtë plan.

Në pasditen 16 nëntorit, situata e trupave gjermane në Tiranë paraqitej si më poshtë: Sulmi i ndërmarrë nga Batalioni Stroschke prej fushës së aviacionit, për të pastruar rrugëkalimin e tërheqjes ishte ndaluar në rrethinat e qytetit pa pasur ndonjë sukses të madh (diku ndërmjet Rrugës së Ambasadave dhe Rrugës së Bogdanëve – M.K). Batalioni i 2-të xhenier i Div. 297, i përforcuar nga ushtarë të Grupit Steyrer, u nda në gjashtë grupe sulmi dhe pasi u pajisën me shishe me benzinë, granata dore dhe bomba djegëse, morën detyrë të kalonin nga shtëpia në shtëpi dhe duke përparuar nga brenda-jashtë t'u vinin atyre flakën. Kompanitë e Batalionit Hahnke do të ndiqnin grupet e sulmit dhe do të pastronin terrenin nga partizanët. I gjithë ky aksion do të mbështetej nga armët e rënda të pozicionuara në fillim të Bulevardit Musolini (*Rrugës së Kavajës*).

Sulmi për hapjen e rrugës filloi në orën 18.00. Fillimisht grupet e sulmit arritën të përparonin në thellësi të rrugës dhe në orën 20.00 u raportua prej tyre se, gjatë pastrimit të rrugës, si pasojë e zjarrit tepër të madh dhe rezistencës së partizanëve, lëvizja kishte ndaluar. Pas ndërhyrjes së katër tankeve rruga e tërheqjes në drejtim të fushës së aviacionit e më pas drejt Vorës ishte hapur. Për këtë gjë Steyrer shkruan në raportin e tij: *“Në orën 21.15 rruga ishte hapur me luftim dhe unë (Steyrer – M.K) mund t'i raportoja divizionit, që mund të fillonte lëvizja e kolonës. Si pasojë e vënies së zjarrit të shtëpive në të dyja krahët dhe sigurimit të rrugës zjarri i armëve kishte heshtur dhe kolonat mundën gjatë natës, thujse pa pësuar humbje, të largoheshin nga qyteti”*.³⁹

Një burim tjetër për luftën e Tiranës dhe për largimin e trupave gjermane nga Tirana përbën edhe dëshmia e Nëntogerit të njësisë së koracuar kundërtanke të Div. 297 Otto Franz Geyer, i cili shkruan: *“[...] më 24 tetor 1944 njësia ime u transferua në Tiranë, sepse situata në*

³⁸ *Po aty*, S. 65.

³⁹ *Po aty*, S. 65.

kryeqytetin shqiptar bëhej gjithnjë e më e rrezikshme. Më 30 tetor papritur filloi në qytet një sulm i përqendruar i partizanëve dhe në të njëjtën kohë u krijuan qendra bandash në lagjen e vjetër të qytetit. Në ditët e tjera pasuan luftime të ashpra në çdo rrugë e shtëpi. Në fazën e fundit të luftës së Tiranës, praktikisht çdo vend ku ndodheshin trupat ishte një bazë më vete. Në këtë kohë në qytet ndodheshin njësia e koracuar kundërtanke e div. 297, toga e parë dhe e dytë e trupave tankiste të zbulimit si edhe një gjysmë toge e kompanisë së tretë si edhe artiljerë bregdetarë. Pak kohë më vonë Tirana do të copëtohej plotësisht: rruga e vjetër për në Durrës (Rruga e Durrësit – M.K) e cila prej vjeshtës 1944 nuk ishte më plotësisht e sigurtë, tani ishte bërë thujse e pakalueshme. Shtabi i njësisë ishte pranë hotel Dajtit, pra thujse në qendër. Kryesisht është merita e togës së parë dhe të dytë të zbulimit tankist, të drejtuar nga Nëntogerët Selinger dhe Rathgebe, që Tirana mund të mbrohej deri sa trupat e fundit të brigadës Steyrer, që erdhën nga Elbasani, hynë në qytet thujse të paorganizuara[...] këto toga furnizonin pozicionet e veçuara gjermane me municion dhe ushqim dhe sillnin në spital të plagosurit. [...] Më 16 nëntor 1944 grupe të dërguara nga Vora hapën me luftim në jugperëndim rrugën e tërheqjes për trupat e rrethuara. [...] Vështirësi të mëdha paraqiste përgatitja e transportit për rreth 1.000 të plagosur dhe të sëmurë rëndë nga spitali i Tiranës. Automjetet dhe po ashtu edhe topat vetëlëvizës dhe topat e sulmit ishin të ngarkuar me të plagosur deri në atë pikë sa të ishin në gjendje të kryenin detyrat luftarake. [...] Në një aksion shpërthyes dramatik u lëviz në drejtim të fushës së aviacionit nëpërmjet shtëpive që digjeshin; gjatë lëvizjes topat 21 cm të artilerisë bregdetare ishin kthyer dhe vendosur në pozicion luftimi [...].”⁴⁰

Historiani gjerman Ch. Stamm është i mendimit – ndoshta duke e vlerësuar si një aspekt të papërfillshëm tërheqjen gjermane në fund të luftës - se në literaturën shqiptare është krijuar një pamje jo reale e përmasave që do të merrte lufta e Tiranës. Ai vlerëson, se partizanët, sido të ndodhte, do të hynin në Tiranë, pasi trupat gjermane që ndodheshin në Tiranë do të plotësonin detyrën e ngarkuar operative e pastaj do të largoheshin.⁴¹

⁴⁰ Otto Franz Geyer, "Panzerjäger auf Selbstfahrlaffeten: Helfer in der Not", in: A. Beck, Bis Stalingrad... Albanien und Jugoslawien (1943-1944), S. 264-265.

⁴¹ Ch. Stamm, "Zur deutschen Besatzung Albaniens...", f. 117.

Që Wehrmacht-i gjerman ishte në largim dhe si pasojë duhej të lëshonte edhe Tiranën, ishte e qartë edhe për drejtuesit partizanë. Por ajo që u interesonte atyre më shumë ishte fakti, se duke i bërë dëmtime sa më të mëdha trupave gjermane ata theksonin fuqinë dhe vendosmërinë e tyre luftarake në nivel ndërkombëtar. Ashpërsinë e luftimeve në Tiranë e mbështesin edhe dokumentet sekrete gjermane gjatë luftës. Sipas raportimeve të Grupit Luftarak të Forcave Tokësore E (*për Korparmatën XXI*) në periudhën 10 - 20.11.44, jepen “1600 burra të vrarë, të plagosur dhe të humbur. 50% e tyre i përkasin Grupit Luftarak Steyrer gjatë luftës në rajonin e Tiranës. Dëmtimi në armë dhe material i ndjeshëm.”⁴²

Të dhëna për humbjet e gjermanëve në Luftën e Tiranës japin edhe burimet britanike. Sipas këtyre burimeve, gjermanët patën mbi 2000 të vrarë, të plagosur dhe të kapur rob. Nga ana tjetër, partizanët shqiptarë patën 127 të vrarë dhe 290 të plagosur.⁴³

Shifra të përafërta me burimet britanike jepen edhe në *Historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare*, botim i vitit 1989. Në të jepet një numër prej afro 2000 ushtarësh gjermanë të vrarë dhe të paktën 500 të plagosur.⁴⁴ Po ashtu në të shkruhet se Grupi Steyrer u asgjësua thuajse plotësisht në rajonin e Tiranës.

Pas vdekjes së Mehmet Shehut më 1981, lufta e Tiranës do të kthehej në një akuzë ndaj tij. Sipas kësaj akuze, Mehmet Shehu e kishte lejuar vetë tërheqjen e trupave gjermane nga Tirana duke mos marrë masa për asgjësimin e tyre të plotë, siç kishte urdhëruar Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH.⁴⁵

Nga dokumentet gjermane, konkretisht nga Raporti Steyrer, në të cilin pasqyrohet deri në detaje tërheqja e trupave gjermane nga Tirana, nuk vlerësohet në asnjë rast ndonjë marrëveshje e mundshme ndërmjet M. Shehut dhe gjermanëve, për të mundësuar largimin e tyre nga Tirana. Mehmet Shehu, që ishte një nga drejtuesit kryesorë të operacionit mësymës në Tiranë, thekson gjithmonë në librin e tij për çlirimin e Tiranës se, forcat partizane synonin asgjësimin e plotë të gjermanëve që

⁴² K. Mehner, *Die Geheimtagesberichte*, S. 240.

⁴³ Hamit Kaba, *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*, Tiranë: Klean, 2015, f. 91.

⁴⁴ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ...*, f. 799.

⁴⁵ *Po aty*, f. 805.

ndodheshin në Tiranë, por si pasojë e mosmbërritjes në kohë të Brigadës IV dhe VII Sulmuese armiku përfitoi nga errësira dhe u largua.⁴⁶

Me të drejtë mund të lindë pyetja, se përse gjatë natës së 16 nëntorit trupat gjermane u larguan nga Tirana thuajse pa pasur humbje gjatë lëvizjes, siç pohon edhe vetë Steyrer-i, ndërkohë që prej afro 19 ditësh kryhej një luftë e ashpër ndaj tyre? Trupat gjermane ishin duke u tërhequr me luftim dhe ishte logjike që ata – nëse i përmbahemi urdhrin të dhënë nga Enver Hoxha - duhej të ndiqeshin pas nga partizanët, siç ndodh rëndom kur kryhet një luftim i tillë. Po ashtu, forcave gjermane u duhej kohë të formatoheshin në rendim marshimi dhe një pjesë e madhe e këtyre trupave, me përjashtim të forcave që duhej të kryenin sigurimin e lëvizjes, duhej të lëshonin pozicionet e luftimit. Kjo gjë patjetër duhet të ketë rënë në sy të partizanëve, për më tepër që bëhet fjalë për luftim në qendër të banuar, ku kundërshtarët ndodhen shumë pranë njëri-tjetrit.

Me shumë rezervë, një shpjegim i këtij veprimi mund të jepet nga skemat e vendimmarrjes operativo-taktike që përdoren në luftimin rrethues, ku trupat rrethuese, me qëllim përfundimin e betejës dhe ruajtjen e fuqisë luftarake të trupave, lejojnë krijimin e një “valvule shkarkimi”, prej nga kundërshtari i rrethuar mund të largohet. Ky është një shpjegim logjik, gjithsesi i parë nga këndvështrimi i sotëm dhe ndoshta i papranueshëm për luftën partizane, qoftë nga pikëpamja ideologjike por edhe nga ajo operativo-taktike.

Raporti ushtarak i Steyrer-it për largimin e trupave gjermane nga Tirana të krijon përshtypjen e tërheqjes duke respektuar një plan të mirëfilltë ushtarak. Sigurisht që për partizanët dhe popullin shqiptar kjo ishte një ngjarje e shënuar, sepse pavarësisht se si ishin zhvilluar luftimet, ishte çliruar kryeqyteti i vendit nga pushtuesit.

Në pikëpamje të mirëfilltë ushtarake mund të thuhet se, gjermanët e lëshuan Tiranën. Ndonëse në kushte të vështira mbrojtëse, sipas urdhrin të marrë, trupat gjermanë arritën të mbajnë qytetin deri në ardhjen e kolonës Steyrer në qytet, duke gdhirë 16 nëntori. Kësisoj, pa dashur të cenojmë sadopak luftën e ashpër 19 ditore të brigadave partizane në rrethinat e Tiranës për marrjen e kryeqytetit, mund të arrijmë në përfundimin se, partizanët e «çliruan» moralisht Tiranën. Urdhri i Enver Hoxhës për “të

⁴⁶ M. Shehu, *Lufta për çlirimin e Tiranës...*, f. 65.

*mos lënë asnjë këmbë gjermani të largohet*⁴⁷ nga Tirana, në fakt, nuk u realizua.

Largimi i gjermanëve nga Shqipëria

Pasi më 17 nëntor 1944 gjermanët u larguan nga Tirana, më 22 nëntor, trupat e mbetura të Korparmatës XXI arritën në qytetin e Shkodrës.⁴⁸ Duke qenë se tërheqja nëpër Nikshiq (*Nikšić*) në drejtim të Trebinjës e Mostarit nuk ishte e mundur, si pasojë e presionit luftarak që ushtronin partizanët jugosllavë⁴⁹, Komandanti i Përgjithshëm i Juglindjes fluturoi personalisht më 22 nëntor 1944 në drejtim të Shqipërisë, për të marrë një vendim për drejtimin e ri të tërheqjes së Korparmatës. U vendos, që trupat të ktheheshin në Podgoricë, në drejtimin Ura e Bioçes – Vjetarnik - Kolašin - Prijepolje (Serbi), ku ato do të bashkoheshin me trupat që tërhiqeshin nga Maqedonia.⁵⁰ Kjo rrugëtërheqje ishte tepër e vështirë, sepse në të kishte shumë ura dhe po ashtu rruga ishte shumë e ngushtë.

Më 22.11.1944, pararoja e Grupimit të Forcave Tokësore E që tërhiqej nga Greqia arriti në Sarajevë dhe kështu u krijua një pikëmbështetje për tërheqjen e trupave gjermanë nga Shqipëria. Por fati i tërheqjes dhe shpëtimi i trupave të Korparmatës XXI do të përcaktohej nga ura e Bioçes, pranë Podgoricës, e cila mund të përdorej për kalim nga trupat gjermane, së pari në datën 28 nëntor 1944.

Kjo urë e ndërtuar mbi lumin Morača, disa kilometër në jug të Manastirit të Moraçës, me një lartësi prej 50 metrash ishte hedhur në erë. Afër saj, ishte edhe një urë tjetër e vogël, e cila po ashtu ishte dëmtuar nga sulmet e avionëve luftarakë, por që për këmbësorinë dhe mjetet e lehta ishte e kalueshme. Mbi lumin Morača ishte ndërtuar edhe një urë dërrase dhe një teleferik për transportin e materialeve. Në rastin më të mirë mbi të mund të kalonin dy burra njëherazi në bregun tjetër.

⁴⁷ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare...*, f. 805.

⁴⁸ K. Mehner, "Die Geheimentagesberichte...", f. 229.

⁴⁹ Më 20.11.1944 gjermanët krijuan me shumë sforco në Podgoricë një grupim luftarak i cili sulmoi për të hapur rrugën në drejtim të Niksiç-it. Ky aksion dështoi dhe shumë shpejt u kuptua se edhe nisja në këtë drejtim i trupave të tjera të Korpusit të dobësuar XXI, nuk do të sillte ndryshimin e dëshiruar të situatës. (G. Hümmelchen, *Balkanräumung 1944...*, f. 582).

⁵⁰ Karl Hnilicka, *Das Ende auf dem Balkan 1943-1944*, Göttingen 1970 (Studien und Dokumente zur Geschichte des Zweiten Weltkrieges, Bd. 15), S. 98.

Meqenëse ura ekzistuese nuk mund të riparohet u urdhërua ndërtimi i një ure të re prej druri, nëpër të cilën do të kalonin trupat e Korparmatës XXI që tërhiqeshin nga Shqipëria.

Situata e trupave gjermanë «të ngecura» në Shkodër si pasojë e bllokimit të rrugës së tërheqjes, raportohet edhe në ditarin luftarak të Wehrmacht-it për datën 27 nëntor 1944. Në të shkruhet: “*Fronti i Adriatikut: Korparmata Malore XXI: presion i vazhdueshëm i bandave në pozicionin pengues në jug të Shkodrës. Në jugperëndim të Podgoricës rritje e intensitetit luftarak. Zgjerim i pozicioneve tona në kryeurën Bioçe.*”⁵¹

Në datën 28 nëntor në po këtë ditar raportohet: “*Fronti i Adriatikut: Presion i vazhdueshëm i bandave ndaj pozicioneve penguese në jug të Shkodrës. Një regjiment i Korparmatës XXI u nis në datën 28.11 herët nga Bioçe, për të hapur rrugën deri në Matesevo.*”⁵²

Në këto kushte, situata për trupat gjermane ishte përmirësuar. Rajoni në të cilin ndodhej ura strategjike ishte marrë dhe lëvizja e trupave të bllokuara në Shkodër, ndërkohë që rruga po çahet me luftim edhe nga drejtimi tjetër, tashmë ishte siguruar. Si pasojë, në mbrëmjen e datës 28 nëntor u lëshuan pozicionet penguese në jug të Shkodrës. Në ditarin luftarak të Wehrmacht-it është shënuar për datën 29.11.44: „ *Fronti i Adriatikut: Në mbrëmjen e datës 28.11. është lëshuar nën presionin e bandave, pozicioni pengues Shkodra. Një kompani turkmene dezertoi dhe kaloi te armiku. Sulmet e bandave ndaj kryeurës Bioçe janë sprapsur. Hapja e rrugës së tërheqjes është kryer deri në rajonin e Klopotit.*”⁵³

Pra, në mbrëmjen e datës 28 nëntor u lëshuan pozicionet mbrojtëse në jug të Shkodrës dhe filloi, sipas taktikës së mirënjohur, tërheqja me luftim dhe në orët e para të mëngjesit të 29 nëntorit 1944, trupat gjermanë lëshuan qytetin e fundit të madh të Shqipërisë, Shkodrën.⁵⁴ Në raportimin sekret të Komandës së Përgjithshme të Juglindjes të datës 30.11.1944 në Komandën e Lartë të Wehrmacht-it shkruhet: “*b) Fronti i Adriatikut: Korpar km në veri - veriperëndim të Shkodrës).* [...]”⁵⁵

⁵¹ BA/MA, RH 19 XI/25, S. 650.

⁵² *Po aty*, S. 656.

⁵³ *Po aty*, S. 664.

⁵⁴ KTB. Bd. 4, S. 725; BA/MA, RH 19 XI/25, S. 664; BA/MA, RH 19 XI/25, S. 180;

Shih edhe Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Tiranë: Toena, 2014, f. 269-337.

⁵⁵ RH 19 XI/25, S. 180.

Me këtë veprim kishte përfunduar pushtimi gjerman i Shqipërisë dhe forcat e Wehrmacht-it vazhdonin tërheqjen e tyre në drejtim të Gjermanisë. Nëse u referohemi burimeve të ambasadës gjermane në Tiranë, gjatë periudhës 14-mujore të pushtimit gjerman në Shqipëri ranë rreth 2400 ushtarë gjermanë. Emrat e 1800 prej tyre janë të identifikuar.⁵⁶ Kjo shifër është shumë larg shifrave që jep historiografia vendase, e cila shkruan për një numër dhjetëra herë më të madh ushtarësh gjermanë që humbën jetën e tyre gjatë luftimeve në Shqipëri.

S u m m a r y

ASPECTS OF THE BATTLE OF TIRANA AND THE WITHDRAWAL OF WEHRMACHT FROM ALBANIA IN NOVEMBER 1944

The concept of the German occupation of Albania was crystallized right before the invasion and it took place on September 1943. According to this concept Albania theoretically would be a neutral and independent country run by a national government, under the rule of the German Wehrmacht. In this framework the German Wehrmacht would organize the defense of territory against a possible deployment of the British and American Allies at the Albanian coast. So, the German Foreign Minister von Ribbentrop hoped to gain the support of the most of Albanians, to isolate the popular liberation movement, and to keep occupied Albania with the least military strength possible.

Most of the Albanians did not agree with such policy. They were organized in the National Liberation Movement and fought against the German occupiers. In this context one of the greatest operations of the partisan army during Second World War was the 'Battle of Tirana'. This battle lasted 19 days and ended on November 17th, 1944. It was characterized by considerable losses from both sides. In the light of new documents for the German archive sources we find out detailed data and new evidences which allow us to have a full picture of this battle and draw right conclusions.

In the second part of this paper it is discussed withdraw of Wehrmacht from Shkodra which was conditioned by the reconstruction of the strategic bridge of

⁵⁶ http://www.tirana.diplo.de/Vertretung/tirana/sq/06/Bilaterale-Kulturbeziehungen/Soldatenfriedhof__Seite__alb.html.

Bioče (Montenegro). This bridge was build by German troops on November 28th, 1944. Thus the concentrated German troops were blocked longer in the city of Shkodra and its suburbs. In the evening of November 28th, after receiving the information on the reconstruction of the Bioče Bridge, Germans started to release the positions in the suburbs of Shkodra and on November 29th, 1944 the German troops left officially the last big city of Albania. Meanwhile the withdraw of the German troops from Albania marked the beginning of a new epoque for Albania.

